



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr 9741/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit H.D nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.K, avokat nga Prizreni, rruga "...", nr.6, kundër debitores Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Arsim, me bazë juridike përbarimore për kompensimin e shujtës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.43/2021 të datës 09.09.2021, jashtë seance me dt.23.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitores Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Arsim, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.43/2021 të datës 09.09.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.43/2021 të datës 09.09.2021, ka vendosur si në vijim: "I. Refuzohet i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, P.nr.22/21 i dt. 12.01.2021, i lejuar nga Zyra Përbarimore e Përbaruesit Privat E.H në Prizren, për shumën prej 478.03€.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e përbarimit në këtë çështje juridike të përbarimit, përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përbarimit, të gjitha shpenzimet e përbarimit do ti bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përbarimor."

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ankesë ka ushtruar pala debitore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta

aprovij ankesën si të bazuar dhe ta anuloj aktvendimin e atakuar si të pa bazuar ose çështjen ta kthej në rivendosije.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj si të pathemeltë ankesën e debitorit, ngase nuk është mbështetur në asnjë nga kushtet e parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezultojn se kreditori H.D nga Rahoveci, me datë 12.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komonale e Arsimit, në bazë të dokumentit përmbartues – Vendimit Administrativ Nr.1742/2020 të datës 29.12.2020, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 478 Euro.

Përmbartuesi privat E.H, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.22/2021 i dt. 12.01.2021, ka lejuar përmbartimin. Kundër urdhrin për përmbartim pala debitorja brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, në të cilin ka theksuar se në këtë rast dokumenti mbi të cilin është bazuar propozimi për përmbartim i mungojnë vetitë e dokumentit përmbartues, dokumenti është i papërshtatshëm për përmbartim, rrjedhimisht është pa efekt juridik, ngase është nxjerr nga organi që ka tejkalluar autorizimet dhe kompetencat ligjore. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, me propozim që prapësimi i palës debitorje të refuzohet në tërësi si i pabazuar, ndërsa urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.43/2021 të datës 09.09.2021, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e debitorit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka konstatuar se caktimi i përmbartimit është bërë duke u bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës nr. 1742/2020, datë 29.12.2020, me të cilin vendim është detyruar që debitorit t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 478.03 € në emër të kompensimit të pagave jubilarje për 36 vite pune. Gjykata ka vlerësuar Vendimin e Inspektoratit të Punës, nr. 1742/2020, datë 29.12.2020, (bazuar në nenin 6 par.4 të Ligjit nr.2002/9 dhe 03/L017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të

punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit), në bazë të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe vlerëson së ky vendim i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par.1 pika 1.1, 23, 25 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim. Gjykata e shkallës së parë po ashtu vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me kompetencën e Inspektoratit të Punës për të vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së. Andaj, pas vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e meqenëse debitori nuk ka ofruar prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 61 e lidhur me nenin 69 par. 4 të LPP-së, dhe nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në pikën 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës, kjo gjykatë vendosi që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi të pabazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) k) dhe m) të LPP-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPP-së.

Gjykata ka konstatuar drejtë faktin se Vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, Nr.1742/2020 të datës 29.12.2020, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar*

procedura e tillë”, e po ashtu i përmban kërkesat nga neni 27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin ku përcaktohet se: “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedhë e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përmbartimin.

Pretendimet e debitorit për shkelje të dispozitave ligjore nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbartimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke iu përmbajtur nenit 144 paragrafi 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin përcaktohet “*një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues*”, pra duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendimi i inspektoratit të Punës Nr.1742/2020 të datës 29.12.2020, është bërë i ekzekutueshëm në momenti që kreditorës i është dorëzuar vendimi. Gjithashtu në pikën III të dispozitivit të vendimit të Inspektoratit të Punës përcaktohet: bazuar në nenin 6 paragrafin 4 i Ligjit nr. 2002/9 dhe 03/L017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ankesa e ushtruar ndaj vendimi të këtij institucioni nuk e shtyn ekzekutimin e Vendimit. Si përfundim, vendim është i përmbartueshëm, përkatësisht titull përmbartimor, ngase ankesa e ushtruar kundër këtij urdhri nuk pengon ekzekutimin.

Nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbartimit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbartimore e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbartimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit përmbartimor dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e LPP-së, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate sipas shkresave të lëndës konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të Vendimit i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës,

Nr.1742/2020 të datës 29.12.2020, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, i cili në mbështetje të dispozitave nga nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, e ka cilësinë e dokumentit përbarimor.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përbarimit në këtë rast.

Gjykata e Apelit gjate shqyrtimit të aktvendimit sipas ankesës së palës debitore ka vërejtur se në arsyetimin e aktvendimit të shkallës së parë është bërë gabim teknik në lartësinë e shumës së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, por që dispozitivi i aktvendimit është i qartë në të cilin është paraqitur shuma e saktë e detyrimit, andaj gabimet teknike në arsyetim nuk kanë relevancë për vendosje ndryshe se si në dispozitivin e këtij aktvendimit, kjo nga shkakun se dispozitivi i aktvendimit përbarohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9741/21, me datë 23.09.2022.

Gjyqtarja,
Nora Bllaca-Dula, d.v.